



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 05/L-155

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË GARANCISË PËR FSDK –
LINJA E DYTË KREDITORE PËR FONDIN PËR SIGURIMIN E
DEPOZITAVE TË KOSOVËS NDËRMJET REPUBLIKËS SË
KOSOVËS DHE BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË GARANCISË PËR
FSDK – LINJA E DYTË KREDITORE PËR FONDIN PËR SIGURIMIN
E DEPOZITAVE TË KOSOVËS NDËRMJET REPUBLIKËS SË
KOSOVËS DHE BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM**

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim të ratifikojë Marrëveshjen e Garancisë për FSDK – Linja e Dytë Kreditore për Fondin për Sigurimin e Depozitave të Kosovës, e nënshkruar ndërmjet Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministri i Financave, dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Neni 2
Ratifikimi i Marrëveshjes

Ratifikohet Marrëveshja e Garancisë për FSDK – Linja e Dytë Kreditore për Fondin për Sigurimin e Depozitave të Kosovës ndërmjet Republikës së Kosovës (përfaqësuar nga Ministri i Financave) dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, e nënshkruar më 22 Dhjetor, 2016, në Prishtinë.

Neni 3
Dokumentet e bashkëngjitura

1. Në Shtojcën e këtij ligji janë të bashkëngjitura dokumentet si në vijim:

1.1. Marrëveshja e Garancisë për FSDK – Linja e Dytë Kreditore për Fondin për Sigurimin e Depozitave të Kosovës ndërmjet Republikës së Kosovës (përfaqësuar nga Ministri i Financave) dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim;

1.2. Marrëveshja për Hua për FSDK – Linja e Dytë Kreditore ndërmjet Fondit për Sigurimin e Depozitave të Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim; dhe

1.3. Termet dhe Kushtet Standarde të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 05/L-155
10 mars 2017

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Kadri VESELI